



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi – Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 18 -2009

Prishtinë, më 25. maj. 2009, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Dzezair Murati, Ibrahim Makolli, Adem Hajdaraj dhe Selvije Halimi.

**Munguan:** Branislav Grbiç, Armend Zemaj dhe Kolë Berisha.

**Të pranishëm:** Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Reshit Gashi – NDI, Petrit Selimi OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Kolë Kurti – KDI, Fidan Morina – “Bota Sot”.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 18 majit 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për ndihmë juridike për vitin 2008;
4. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari – I përshëndeti të gjithë të pranishmit. Në veçanti i falënderoi komisionarin e ndihmës juridike, z. Sokol Hazirin me bashkëpunëtorë për praninë në Komision dhe organizatat që e mbështesin punën e Komisionit. I njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 18 majit 2009**

Kryetari – I pyeti anëtarët a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje*

## **3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Ndhmës Juridike për vitin 2008**

**Kryetari** - Edhe javën kaluar e kemi pasur në rend dite Raportin e punës të Komisionit të Ndhmës Juridike. Në këtë takim e kemi ftuar komisionarin që po na respekton me pjesëmarrje. Ai do ta marrë fjalën që ta sqarojë para anëtarëve të Komisionit Raportin e punës të Komisionit të Ndhmës Juridike. Vlen të përmendet se Raporti i Komisionit të Ndhmës Juridike ka ardhur me kohë në Komisionin tonë. Do të diskutojmë për Raportin dhe do ta rekomandojmë për seancë plenare. Fjalën ia dha komisionarit të ndihmës juridike, z. Sokol Haziri.

**Sokol Haziri** – E falënderoi Komisionin që e ka ftuar të diskutojë për Raportin e Komisionit të Ndhmës Juridike. Shtoi se ky është raporti i dytë që është dërguar në Kuvendin e Kosovës. U ndal edhe te baza juridike e Komisionit të Ndhmës Juridike, për të cilin tha se është i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/36. Foli edhe për organizimin e Komisionit të Ndhmës Juridike, për mjetet buxhetore, financimet, punën, vështirësitë si dhe për raportimin në Kuvendin e Kosovës. Në fund tha se është i gatshëm të bashkëbisedojë për secilën çështje që e konsiderojmë të nevojshme.

**Kryetari** – E falënderoi zotin Haziri për Raportin. Tha dihet se ndihma juridike është kategori kushtetuese, por u interesua për disa çështje, si: përbërja e Komisionit të Ndhmës Juridike prej 1 komisionari dhe 8 zëvendëskomisionarëve. Pyeti pse është kjo përbërje dhe a është efikase, sa i marrin pagat dhe me çfarë vendimi janë rregulluar ato? Çka mendon pas dekretimit të dy anëtarëve të Komisionit për ndihmë juridike në Gjykatën Kushtetuese (Altayi Suroi dhe Gjyljeta Mushkolaj)? U interesua edhe për çështjen e mandateve, të buxhetit, për të cilin tha se nuk e keni shfrytëzuar, si dhe për çështjen e prokurimit, për të cilin e keni vetëm një zyrtar të prokurimit.

**Bajram Kosumi** – Tha se Komisioni ynë në të ardhmen duhet të përkrah Komisionin e Ndhmës Juridike. Kjo duhet të rregullohet me ligj dhe me miratimin e ligjit do të eliminojmë disa prej pengesave dhe parregullsive në funksionimin e Komisionit.

Shtroi edhe çështjen e efikasitetit praktik të byrove të qarkut dhe të bordit. Nëse e marrim si shembull byronë më të suksesshme, atë të Qarkut të Mitrovicës, që ka trajtuar 328

lëndë dhe nëse e pjesëtojmë këtë numër me numrin e zyrtarëve në Byro, atëherë del se byroja me gjithë zyrtarët ka punuar disa ditë në një lëndë. Kjo është një punë jo efektive, shumë e ngathtë. Problemi tjetër është pyetja se a janë përcjellë lëndët dhe rastet deri në fund? Sa kanë rezultuar të efektshme shërbimet e Byrosë? Problemi i tretë është problemi i Bordit të komisionit: nëntë anëtarë udhëheqin rreth 30 zyrtarë të Komisionit: nëse ka nevojë duhet të shtohet numri i zyrtarëve, nëse jo atëherë duhet të zvogëlohet numri i anëtarëve të Bordit.

**Ibrahim Makolli** – Tha se efikasiteti i Komisionit të Ndihmës Juridike është shumë i dobët dhe shtoi se vetëm 1/4 e këtyre mjeteve buxhetore shkon për ofrimin e ndihmës juridike. Foli edhe për çështjen e numrit të madh të zëvendëskomisionarëve, për çështjen e sigurimit të mjeteve, të fondeve nga donacionet e huaja, si dhe për çështjen e njoftimit (sensibilizimit) të qytetarëve për ekzistimin e Komisionit të Ndihmës Juridike. Jam i bindur se shumica e qytetarëve nuk e dinë se ekziston ky komision. Shtroi edhe çështjen e akteve nënligjore, për të cilat pyeti a janë nxjerrë. Theksoi se do të na ndihmonte shumë angazhimi i studentëve dhe bashkëpunimi me Odën e Avokatëve. Në fund tha se është i nevojshëm ekzistimi i Komisionit për Ndhmë Juridike.

**Adem Salihaj** – Ngriti çështjen e përbërjes së komiteteve. Pyeti sa anëtarë i kanë dhe si është rregulluar kjo çështje. Shtoi se nga Raporti del se nuk e kanë parë fare atë, fjala është për versionin final, sepse ju e patë edhe vetë çfarë gabimesh ka. Nga kjo shihet se në Komisionin e Ndhmë Juridike nuk ka punë të efektshme. Jam i mendimit t'i propozojmë Ministrisë së Drejtësisë që ta hartojë një projektligj, në mënyrë që të rregullohet kjo çështje e rëndësishme.

**Sokol Haziri** – Duke e marrë fjalën për herë të dytë shtoi se përbërja e bordit prej 8 anëtarëve dhe komisionarit është e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/6. Sa i përket strukturës lirisht mund të thuhet se ajo është heterogjene dhe se ka anëtarë që nuk e dinë pse janë aty. Kjo paraqet vështirësi për marrjen e vendimeve. Nuk kemi paga, por honorarë. Honorari paguhet në bazë të mbledhjeve që mbahen. Anëtarët e Bordit paguhën 250 euro në muaj, ndërsa shërbyesit civilë 200 deri 250 euro. Kemi pasur vështirësi për shpenzimin e buxhetit për shkak të pranisë së UNMIK-ut. P.sh. ka zgjatur 7 muaj pranimi i një zyrtari për teknologji informatike, kurse prokurimin deri në qershor dhe në korrik e ka kryer UNMIK-u. Tash e kemi angazhuar një zyrtar të prokurimit. Për dy anëtarët që kanë kaluar në Gjykatën Kushtetuese do t'i dërgojmë shkresë kryeministrit. Brenda 60 ditësh do të emërohen anëtarët e rinj. Është e vërtetë se qytetarët nuk dinë për ekzistimin e Komisionit për Ndhmë Juridike, por ka edhe të atillë që ngurrojnë ta kërkojnë ndihmën e tij. Deri më tash nuk i kemi angazhuar studentët. Kam kërkuar që për Komisionin e Ndhmës Juridike auditimi të bëhet nga jashtë, sepse nuk kemi të brendshëm. I falënderoi anëtarët e Komisionit dhe shtoi se ai është për agjenci të pavarur ose për agjenci që vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, sepse Kosova ka nevojë për ndihmë juridike.

**Kryetari** – Në emër të Komisionit e falënderoi z. Haziri për sqarimet rreth Raportit.

Në fund Komisioni nxori këto rekomandime:

- Qeveria të hartojë projektligjin për Komisionin e Ndhmës Juridike;
- Komisioni i Ndhmës Juridike as nuk është i organizuar mirë, as nuk është funksional;
- Të definohet qartë statusi i shërbyesve civilë në byrotë e qarkut;
- Kosova ka nevojë për ndihmë juridike, sepse ajo është kategori kushtetuese.

#### **4. Të ndryshme**

Kryetari i njoftoi të pranishmit edhe për takimin që ka pasur me Komisionin e Integriteteve Evropiane lidhur me Planin e veprimit, me Raportin e progresit dhe me detyrat që dalin për Komisionin tonë. Shtoi se Komisioni mbikëqyrë zbatimin e disa ligjeve. Po ashtu vuri në pah se jemi duke i hartuar disa projektligje të tjera dhe jemi të stërngarkuar me punë.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe në orën 15:55 e shpalli mbledhjen të mbyllur.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni